


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Tetor 2020

Tiranë, më 09 Nëntor 2020: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Tetor 2020, arriti 108,5 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Tetor 2020 është 2,0 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,3 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Tetor 2020, krahasuar me Shtator 2020 është 0,2 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)




Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit.

Rritja vjetore e çmimeve në muajin Tetor është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,81 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,32 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” kanë kontribuar me +0,09 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,05 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Hotele, kafene dhe restorante” kanë kontribuar me +0,03 pikë. Çmimet e grupit “Komunikimi” kanë kontribuar me +0,02 pikë. Çmimet e grupit “Pije alkoolike dhe duhan” kontribuar me +0,01 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me -0,27 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” kanë kontribuar me -0,03 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Shëndeti” dhe “Argëtim dhe kulturë” kanë kontribuar me -0,01 pikë përqindje secili.

Për publikim 09/11/2020

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Tetor 2019, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 4,9 %, pasuar nga grupet “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 1,5 % secili, “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,9 %, “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,8 %, “Komunikimi” me 0,5 % dhe “Pije alkoolike dhe duhan” me 0,3 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 4,3 %, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 0,8 %, “Shëndeti” me 0,4 % dhe “Argëtim dhe kulturë” me 0,3 %. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit “zarzavate përfshirë patatet” u rritën me 18,5 %, pasuar nga nëngrupet “fruta” me 11,5 %, “vajra dhe yndyrna” me 4,7 %, “sheqer, recel, mjaltë, çokollata, dhe ëmbëlsira” me 2,6 %, “peshk” me 2,3 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Shtator 2020, çmimet e grupit “Ushqime dhe pije joalkoolike” u rritën me 0,6 %, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” me 0,3 %, “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” me 0,2 % secili, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 0,1 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 0,4 %, pasuar nga grupet “Argëtim dhe kulturë” me 0,2 %, “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Shëndeti” me 0,1 % secili.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	10-19	11-19	12-19	01-20	02-20	03-20	04-20	05-20	06-20	07-20	08-20	09-20	10-20
	Gjithsej	100	106,4	106,2	107,1	109,1	109,5	110,2	109,7	108,8	108,1	107,6	107,8	108,2	108,5
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	37,3	111,7	111,2	113,4	118,4	119,5	121,7	120,5	118,0	116,3	114,7	115,2	116,4	117,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,4	104,8	104,9	104,6	105,2	105,3	105,5	105,3	105,4	105,4	105,5	105,6	105,3	105,2
3	Veshje dhe këpucë	3,6	99,4	99,6	99,7	99,6	99,4	98,9	98,9	98,3	98,6	98,6	98,3	98,4	98,6
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,9	105,2	105,2	105,4	106,8	106,8	106,8	106,7	106,8	106,6	106,5	106,6	106,7	106,8
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,4	101,0	101,2	101,4	101,3	101,3	101,5	102,6	102,4	102,4	102,2	102,7	102,3	102,5
6	Shëndeti	3,5	99,5	99,4	99,4	99,2	99,1	99,3	99,3	99,3	99,3	99,3	99,3	99,2	99,1
7	Transporti	6,3	102,2	102,1	102,8	102,7	102,5	100,3	98,6	97,9	97,8	97,9	98,4	98,2	97,8
8	Komunikimi	3,0	101,2	101,2	101,2	101,0	101,0	100,9	100,9	101,7	101,7	101,7	101,7	101,7	101,7
9	Argëtim dhe kulturë	2,4	108,0	107,1	107,3	106,8	107,5	107,5	108,4	108,0	108,8	107,9	107,9	107,9	107,7
10	Shërbimi arsimor	2,9	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,2	102,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	3,9	102,4	102,5	102,5	102,7	102,8	102,8	102,9	102,8	102,8	102,9	102,9	102,9	103,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	6,3	103,8	103,8	103,9	103,9	104,0	103,9	103,8	103,9	104,0	104,3	104,3	104,7	104,7

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	10-19/10-18	11-19/11-18	12-19/12-18	01-20/01-19	02-20/02-19	03-20/03-19	04-20/04-19	05-20/05-19	06-20/06-19	07-20/07-19	08-20/08-19	09-20/09-19	10-20/10-19
	Gjithsej	1,3	1,4	1,1	1,5	1,2	2,1	1,9	2,1	1,8	1,4	1,3	1,5	2,0
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	3,0	3,2	2,6	2,4	1,9	4,6	4,3	4,9	4,1	3,1	3,1	3,8	4,9
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,4	1,1	0,2	0,5	0,7	0,8	0,6	0,6	0,6	0,7	0,6	0,4	0,3
3	Veshje dhe këpucë	-0,1	-0,3	-0,2	-0,6	-0,7	-0,6	-0,7	-0,7	-0,5	-0,2	-0,2	-0,7	-0,8
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	0,1	0,1	1,5	1,4	1,7	1,3	1,4	1,4	1,4	1,5	1,5	1,5
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	1,4	1,5	1,2	1,2	0,8	0,9	1,9	1,9	2,0	1,8	1,9	1,3	1,5
6	Shëndeti	-0,1	0,0	-0,4	-0,6	-0,7	-0,6	-0,7	-0,6	-0,6	-0,2	-0,2	-0,4	-0,4
7	Transporti	-2,0	-1,6	0,2	1,5	1,2	-1,5	-3,1	-3,7	-4,0	-4,8	-5,8	-4,6	-4,3
8	Komunikimi	0,1	0,0	-0,1	-0,3	-0,3	-0,4	-0,3	0,4	0,4	0,5	0,5	0,5	0,5
9	Argëtim dhe kulturë	1,2	2,1	2,2	2,3	2,4	2,4	3,8	2,7	2,9	1,4	0,0	-0,4	-0,3
10	Shërbimi arsimor	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,2	1,3	0,6	0,9	0,8	0,7	0,8	0,7	0,5	0,5	0,6	0,6	0,8
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,3	0,2	0,2	0,1	0,3	0,1	0,0	0,3	0,3	0,6	0,6	0,9	0,9

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	10-19	11-19	12-19	01-20	02-20	03-20	04-20	05-20	06-20	07-20	08-20	09-20	10-20
	Gjithsej	-0,2	-0,1	0,8	1,9	0,4	0,6	-0,4	-0,8	-0,6	-0,5	0,2	0,4	0,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	-0,5	-0,4	2,0	4,4	1,0	1,8	-1,0	-2,1	-1,5	-1,3	0,4	1,0	0,6
2	Pije alkoolike dhe duhan	-0,1	0,0	-0,2	0,6	0,1	0,1	-0,2	0,1	0,1	0,1	0,1	-0,3	-0,1
3	Veshje dhe këpucë	0,4	0,1	0,1	-0,1	-0,2	-0,5	-0,1	-0,5	0,3	0,0	-0,3	0,0	0,3
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	0,0	0,2	1,3	0,0	0,0	-0,1	0,0	-0,2	0,0	0,1	0,0	0,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,0	0,2	0,2	-0,1	0,0	0,2	1,1	-0,1	0,0	-0,2	0,5	-0,4	0,2
6	Shëndeti	-0,1	-0,1	0,0	-0,2	-0,1	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,1	-0,1
7	Transporti	-0,7	-0,1	0,6	0,0	-0,2	-2,2	-1,7	-0,7	-0,1	0,1	0,5	-0,2	-0,4
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,0	-0,2	0,0	-0,1	0,0	0,8	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	-0,3	-0,8	0,2	-0,5	0,6	0,0	0,8	-0,4	0,8	-0,9	0,1	0,0	-0,2
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,1	0,0	0,3	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	0,2
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	-0,1	0,1	0,0	0,1	-0,1	-0,1	0,1	0,1	0,3	0,0	0,3	0,0

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2018.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

INSTAT gjatë periudhës së Pandemisë ka ndjekur rekomandimet më të fundit metodologjike të EUROSTAT dhe të partnerëve të tjerë ndërkombëtarë.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.